



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË

Kryesuese e Senatit
Prof.dr. Nurten Deva

Nr. Prot. 3095 Dt 26.12.2024

Bazuar në nenin 48 dhe 49 të Statutit të UIBM dhe bazuar në nenin 18 pika 6, Senati i Universitetit "Isa Boletini", në Mitrovicë, në mbledhjen e mbajtur më 24.12.2024, mori:

VENDIM

- I. Anulohet konkursi me nr.prot.1864, publikuar me dt. 09.09.2024 për zgjedhjen, rizgjedhjen dhe avancimin e personelit akademik në fakultetet e Universitetit "Isa Boletini" për vitin akademik 2024/2025;
- II. Anulimi i konkursit të shpallur më dt.09.09.2024 bëhet për pozitën e shpallur:

Zgjedhje për herë të parë në thirrjen përkatëse:

1. Një mësimdhënës për lëndët: "Vlerësimi dhe hapja e minierave", "Shfrytëzimi nëntokësor", "Aplikimi i gjeomekanikës së avancuar", "Modelimi numerik në gjeomekanikë", "Projektimi në shfrytëzimin nëntokësor".

- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Anulimi i konkursit për pozitën nga pika II e vendimit bëhet për arsye të tejkalimit të afateve të përcaktuara me nenin 17 pika 8 dhe 9 të Rregullores me nr.prot.3013 dt.21.12.2023 për procedurat e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik. Bazuar në këto që u cekën, Senati mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Komisionin për Ankesa dhe Parashtresa të Senatit të UIBM, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakultetit të Gjeoshkencave;
3. Zyrës për informim me publikun;
4. Zyrës për çështje akademike;
5. Zyrës ligjore;

Prof.dr.Nurten Deva

N. Deva

Kryesuese e Senatit

